VENDIM
Nr.602, datë 9.9.1996

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË TREGTARE, MINIERA E BITUMIT SELENICË

Në zbatim të ligjit nr.8026, datë 9.11.1995 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorin minerar", me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minierare dhe Energjetike dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të autorizojë Agjencinë Kombëtare të Privatizimit për privatizimin e kapitalit të shoqërisë anonime Miniera e Bitumit Selenicë në Vlorë, sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura nga komisioni i ekspertëve (i ngritur për këtë qëllim nga Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Ministria e Financave) dhe të paraqitura në lidhjen që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

KUSHTET E KONTRATËS SË SHITJES

Objekti: Miniera e Bitumit Selenicë sh.a., Vlorë;
Përqindja e aksioneve që privatizohen: 70 për qind;
Vlefta: 51 milionë lekë;
Mënyra e pagesës: në lekë;
Firma fituese VEFA Holding;
Invstimet e ardhshme:940 milionë lekë në vitet 1996-2000;
Kushte të tjera: Mbrojtja e mjedisit, mbrojtja në punë e fuqisë punëtore ekzistuese dhe rritja e numrit të tyre në të ardhmen.